

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 836 Prot.

Tiranë, më 19.06 2017

VENDIM Nr. 138, datë 05.06.2017

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave të dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje", Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, të datës 05.06.2017, pasi shqyrtoi Kërkesën e ALUIZNI-it Sarandë, për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit për objektin 4 kat të z. *Brahim Mete Zeneli, ndodhur në Lagjen Nr.2, dhe i pozicionuar brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Sarandës,*

VENDOSI:

1. Të miratojë Kërkesën e ALUIZNI-it Sarandë, për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit për objektin 4 kat të z. *Brahim Mete Zeneli, ndodhur në Lagjen Nr.2, dhe i pozicionuar brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Sarandës.*
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FERXHI  
MINISTRE



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO

